

KËRKESË PADI

PADITËS: **Dashamir TAHIRI**, i biri i Mehmetit dhe i Havasë, i datëlindjes 16.09.1966, lindur në Vlorë (Skelë) dhe banues në Vlorë, në cilësinë e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Av. Fatmir Braka dhe Av. Julian Mërtiri, anëtarë të Dhomës së Avokatëve Tiranë, me adresë njoftimi në Tiranë, rruga "Ismail Qemali", pall. 11/1, ap. 1.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, me seli në Tiranë, rruga "Ibrahim Rugova", nr. 4.

PALË E

INTERESUAR: **Prokuroria e Përgjithshme**, me seli në Tiranë, rruga "Qemal Stafa".

OBJEKTI: Shfuqizimi i Vendimit nr. 176, datë 29.12.2016 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Dashamir Tahiri, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, me të cilin është shpallur i pavlefshëm dhe përfunduar në mënyrë të parakohshme mandati i deputetit z. Dashamir Tahiri.

BAZA LIGJORE: Nenet 145, 152, 153, 158 e vijues të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 *"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; Ligji nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, i ndryshuar; Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuar në Ligjin nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike'"*.

PËRPARA

KOLEGJIT ZGJEDHOR TË GJYKATËS SË APELIT

TIRANË

Të nderuar zotërinj Gjyqtarë!

Në mbledhjen e tij të datës 29.12.2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me Vendimin nr. 176, datë 29.12.2016 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Dashamir Tahiri, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, ka vendosur:

- "1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z. Dashamir Tahiri.*
- 2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit.*
- 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.*
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit".*

Nga përmbajtja e vendimit të KQZ, konstatohet se ai është mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a) e Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 *"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; në nenin 10, pika 1, germa d), neni 14, 15, pika 3 të Ligjit nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, pikat 12, 13, 14 të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike'"*.

Vendimmarrja e KQZ, ka lejuar në pikën 4 të dispozitivit të saj, mundësinë e bërjes së ankimit *"sipas ligjit"*, por pa specifikuar se kujt ligji i referohet dhe cili është organi gjyqësor, tek i cili duhet të paraqitet kundërshtimi/ankimi i z. Dashamir Tahiri, si personi të cilit i janë cenuar interesat, duke iu përfunduar në mënyrë të parakohshme mandati i deputetit. Veprim ky, i cili, përpos shkeljeve dhe zbatimit të gabuar dhe flagrant të ligjit nga KQZ, vjen në kundërshtim dhe me pikën 5 të nenit 144 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilës: *"Vendimi i KQZ përmban edhe sqarimin për të drejtën e palëve për ta ankimuar atë në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit"*.

Në këto kushte, jemi të detyruar që çështjen ta bëjmë objekt të shqyrtimit nga Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në përcaktimet e neneve 145, 152, 153, 158 e vijues të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 *"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"*. Kjo dhe për faktin se ligji specifik, Ligji nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, nuk ka trajtuar dhe as përcaktuar në ndonjë dispozitë të tij ndonjë mënyrë ankimi kundër vendimit të KQZ të marrë në zbatim të këtij ligji specifik, duke mos garantuar dhe praktikisht cenuar të drejtën e subjektit të interesuar për t'u ankuar përpara organeve gjyqësore, nëpërmjet një procedure të qartë dhe të detajuar ligjore.

Vendimi nr. 176, datë 29.12.2016 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Dashamir Tahiri, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, shfuqizimi i të cilit kërkohet nga ana jonë, përbën një vendimmarrje e arritur nga KQZ (me shumicë votash, 4 pro dhe 3 kundër vendimmarrjes përfundimtare), në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit, duke cenuar në kundërshtim me ligjin, mandatin e ligjshëm të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Dashamir Tahiri.

Në lidhje me gjendjen faktike dhe analizës juridike të këtij rasti, sqarojmë se, në shqyrtimin e çështjes përpara KQZ, rezultoi se në datën 20.12.2016 Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimin *"Për miratimin e rezultateve të verifikimit, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015"*, i datës 20.12.2016 të Sektorit të Verifikimit të Integritetit, i marrë në përfundim të shqyrtimit të akteve të verifikimit për shtetasin Dashamir Mehmet Tahiri, me funksion deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Nga praktika e ndodhur pranë KQZ si edhe nga përmbajtja e vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, u konstatua se i paditësi Dashamir Tahiri, në datën 31.03.2016 ka plotësuar dhe depozituar pranë KQZ-së, Formularin e Vetëdeklarimit *"Për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, protokolluar në këtë institucion me nr. 423 prot.

Formulari i Vetëdeklarimit, në rastin e z. Dashamir Tahiri, është plotësuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"* dhe ato të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr. 138/2015 ..."*.

Paditësi, si subjekt i ligjit, ka deklaruar të dhënat e tij personale, nga të cilat rezulton se ai nuk ka pasur gjeneralitete të mëparshme dhe se ato aktuale janë të deklaruara dhe të detajuara saktë prej tij.

Po ashtu, në 8 (tetë) rubrikat e Formularit të Vetëdeklarimit, prej tij është deklaruar se:

1. Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;

2. Nuk është dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
3. Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e ndonjë veprë penale;
4. Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë veprë penale;
5. Nuk është caktuar ndaj tij ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
6. Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar, lidhur me kryerjen e veprave penale;
7. Ndaj tij nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga shteti i huaj;
8. Në vitet 1990 – 1993 z. Dashamir Tahiri ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në shtetin e Italisë, qyteti i Modenas.

Dhe në fakt, këto të dhëna, rezultojnë ligjrisht të sakta, bazuar mbi njohuritë që vetë subjekti, pra z. Dashamir Tahiri ka pasur në momentin e plotësimit të Formularit të Vetëdeklarimit, pra në datën 31.03.2016.

Edhe vetë KQZ, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka kryer fillimisht verifikimet e tij, duke i rezultuar se, nga Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore (sipas Shkresës nr. 3689/4 prot., datë 01.06.2016) është kthyer përgjigje duke u konfirmuar fakti se z. Dashamir Tahiri është i padënuar brenda vendit për ndonjë veprë penale, me vendim të formës së prerë.

Gjeneralitetet e z. Dashamir Tahiri janë konfirmuar të sakta, pa ndryshime, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (sipas Shkresës nr. 3240/3 prot., datë 12.07.2016).

Pavarësisht këtyre të dhënave të deklaruara saktë nga subjekti, nga Prokurori i Përgjithshëm është vepruar sipas përcaktimit të nenit 7, pika 1, germa a) e Ligjit nr. 138/2015, duke u kërkuar verifikimi i të dhënave të deklaruara në Formularin e Vetëdeklarimit nga z. Dashamir Tahiri. Po ashtu, nga KQZ, në datën 08.11.2016 i është kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme verifikim i thelluar për të dhëna jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u përcjellë edhe Formulari i Vetëdeklarimit i plotësuar dhe i deklaruar nga z. Dashamir Tahiri.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, nga Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë këtij institucioni, është kërkuar informacion pranë Zyrës Ndërlidhëse të Italisë, nëpërmjet

Zyrës Kombëtare Europol, pranë Ministrisë së Brendshme, e cila në datën 01.11.2016 (pra përpara kërkesës së KQZ për nisjen e verifikimit të thelluar) ka kthyer përgjigjen në lidhje me subjektin z. Dashamir Tahiri:

- Në vitin 1995, është raportuar nga policia në Foggia, për krime në lidhje me falsifikimin e parave;
- Në vitin 2009, është dënuar nga Gjykata në Ravena (për të vuajtur 9 muaj burgim), për përdorim të një leje drejtimi shqiptare të falsifikuar;
- Subjekti është kontrolluar disa herë nga policia.

Bazuar mbi këtë informacion të ardhur nga shteti Italian, z. Dashamir Tahiri është thirrur për të dhënë shpjegime pranë Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me faktet të cilat i atribuoheshin. **Paditësi ka deklaruar se, për sa i përket dënimit në Ravena, ishte hera e parë që ai informohej se qenka dënuar. Pra, ai nuk ka pasur asnjë dijeni të mëparshme për këtë fakt.** Në rrethanat e faktit, ai ka deklaruar për sa i përket ngjarjes se, diku në vitin 2004, kur ndodhej në Itali, ai ka debatuar me një polic bashkiak, duke qenë se, i ndodhur në makinë, përdorte celularin dhe kur është ndaluar, i janë kërkuar dokumentet e makinës, ndër të cilat edhe Lejen e Drejtimit (Patentën) shqiptare. Nga ai moment ai nuk ka pasur asnjë dijeni se çfarë ka ndodhur më tej, duke qenë se as nuk është ndaluar dhe as janë ndjekur procedura të tjera nga institucionet italiane.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, në rastin konkret për z. Dashamir Tahiri ekziston një vendim dënimi për përdorimin e një Lejeje Drejtimi të falsifikuar, fakt i cili parashikohet si veprë penale nga legjislacioni shqiptar, në Seksionin VIII “Falsifikimi i Dokumenteve”.

Duke qenë se në rastin konkret subjekti është dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim, për veprën penale të lidhur me përdorimin e Lejes së Drejtimit shqiptare të falsifikuar, atëherë sipas Prokurorisë së Përgjithshme ky rast përfshihet në fushën e veprimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, konkretisht neni 2, pika 1, germa ç) e tij.

Nga KQZ, në shqyrtimin e rastit konkret, u zhvilluan 2 mbledhje, në datat 27 dhe 29 dhjetor 2016. Mbledhja e parë u ndërpre dhe e dyta u caktua 48 orë më vonë, me qëllim që KQZ të kërkonte nga Prokuroria e Përgjithshme informacion shtesë, në kushtet kur edhe vetë KQZ krijoi bindjen se informacioni që përmbante Vendimi “Për miratimin e rezultateve të verifikimit, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015”, i datës 20.12.2016 i Prokurorisë së Përgjithshme, i marrë në përfundim të shqyrtimit të akteve të verifikimit për shtetasin

Dashamir Mehmet Tahiri, me funksion deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ishte i paplotë dhe i pamjaftueshëm për t'u vijuar me shqyrtimin sipas ligjit nga KQZ.

Dhe në fakt, nga përmbajtja e vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme nuk ishte saktësuar as data, as numri dhe as çfarë ishte vendosur për paditësin Dashamir Tahiri nga Gjykata e Ravenas, duke u shprehur vetëm se, citojmë: *"Në vitin 2009, është dënuar nga Gjykata në Ravena (për të vuajtur 9 muaj burgim), për përdorim të një leje drejtimi shqiptare të falsifikuar"*. Pra, në një mënyrë haptazi jo ligjore dhe në cenim flagrant të të drejtave të paditësit, Prokuroria e Përgjithshme pretendonte një vendim, diku në vitin 2009 (!) pa kurrfarë ekstremitetesh konkrete dhe as se çfarë ishte vendosur me atë vendim të drejtësisë italiane.

Në përgjigje të kërkesës së KQZ për kërkim informacioni shtesë, me Shkresën nr. 1548/8 prot., datë 28.12.2016, Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme, për sa i takon paditësit Dashamir Tahiri, është shprehur se:

"Referuar vendimit të Prokurorit të datës 20.12.2016 për subjektin vetëdeklarues z. Dashamir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, citojmë vendimin ... (Në vitin 2009 është dënuar nga Gjykata në Ravenna (për të vuajtur 9 muaj burgim), për Përdorim të një leje drejtimi shqiptare të falsifikuar. Vendimi i Gjykatës mban datën 28.10.2009 dhe është i formës së prerë.

Ndaj subjektit deklarues rezulton se ka një vendim dënimi për përdorimin e një leje drejtimit të falsifikuar, parashikuar dhe nga legjislacioni shqiptar në Seksionin VIII "Falsifikimi i dokumenteve".

Rrjedhimisht, vepra penale e kryer dhe dënimi i dhënë, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa ç) të Ligjit nr. 138/2015 ... pasi subjekti është dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim për veprën penale "Përdorimi i një lejeje drejtimi të falsifikuar".

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, në vendimin e saj të datës 20.12.2016, ka ekzistuar i gjithë informacioni i nevojshëm për t'u marrë vendimi nga KQZ. Por në fakt provohet e kundërta, pasi në Vendimin e datës 20.12.2016 jo vetëm që nuk ekzistonte i plotë informacioni por referohej vetëm një vit kalendarik (!), konkretisht viti 2009, i cili sigurisht që përmban 365 ditë dhe vendimi mund të ishte marrë në secilën prej tyre! Po ashtu, edhe në Kthim Përgjigjen e datës 29.12.2016, Prokuroria e Përgjithshme, pretendon se vendimi është i datës 28.10.2009 dhe kaq.

Por, së pari vendimi daton plot 5 (pesë) muaj më parë (!) në datën 29.05.2009 dhe njëkohësisht rezulton se Prokuroria e Përgjithshme në asnjë moment nuk ka marrë dhe

administruar këtë vendim nga Gjykata italiane dhe autoritetet përkatëse, sipas ligjit dhe kërkesave të Ligjit nr. 138/2015 dhe Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016. Nga këto fakte, qartësohet shkelja e hapur e të drejtave të paditësit Dashamir Tahiri, në rastin e të cilit, çuditërisht Prokuroria e Përgjithshme është mjaftuar me administrimin e vetëm të një informacioni policor (!) dhe jo të vetë vendimit gjyqësor! Theksojmë me forcë se Shkresa nr. 794/1 prot., datë 01.11.2016 e ardhur për Prokurorinë e Përgjithshme nga Zyra Ndërlidhëse e Interpol nëpërmjet Zyrës Kombëtare të Europol, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk mund të përbëjë bazën e hetimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe dokumentin zyrtar për vendimmarrjen e saj, për sa kohë që nuk u mor dhe as u administrua vendimi gjyqësor i Gjykatës italiane.

Me Vendimin e datës 20.12.2016, në referim të nenit 8, pika 2 e Ligjit nr. 138/2015 sipas të cilit: *“Përfundimet e procesit të verifikimit i përcillen organit përgjegjës nga Prokuroria e Përgjithshme, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre”*, dhe ato të Kreut V, pikat 10 dhe 11 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur:

“Përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin se subjekti deklarues Dashamir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, përfshihet në fushën e ndalimit të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa c) të Ligjit nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’.

Për sa më lart, në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr. 138/2015 dhe të pikave 12, 13 dhe 14 të Kreut V të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuar në Ligjin nr. 138/2015 ...”*, KQZ si organi përgjegjës, duhet shqyrtonte nëse nga procesi i verifikimit janë evidentuar të dhëna të cilat përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2 i Ligjit nr. 138/2015 dhe nëse po, duhet të verifikonte nëse këto të dhëna përfshiheshin brenda periudhës së ndalimit, të përcaktuar në nenin 4 të Ligjit nr. 138/2015.

Vetëm nëse të dhënat përfshihen brenda periudhës së ndalimit, organi përgjegjës (në rastin konkret KQZ) merr vendim për zbatimin e masave për largimin nga funksioni publik të subjektit, çka në interpretim të nenit 10 *“Verifikimet e organeve kompetente kur verifikohen kushtet e ndalimit”*, pika 1, germa d) përfaqësohet nga shpallja e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimi i parakohshëm i tij.

Duke ekzistuar sa më lart, rrethanat e faktit të cilat u morën në shqyrtim nga KQZ, në rastin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Dashamir Tahiri nga analiza e mëposhtme, rezultoi e provuar se në rastin e tij nuk plotësohen kërkesat e ligjit, pasi të

dhënat e pretenduara nga Prokuroria e Përgjithshme nuk përfshihen brenda periudhës së ndalimit, sipas përcaktimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Fakt për të cilin pas këtij procesi të verifikimit ligjor, KQZ duhet të vendoste përfundimin e shqyrtimit, duke konstatuar se në rastin e z. Dashamir Tahiri, nuk ekzistonin rrethanat për ndalimin e zgjedhjes apo emërimit të tij.

Për sa i përket pretendimeve të ngritura nga Prokuroria e Përgjithshme, në Vendimin e datës 20.12.2016 përcjellë KQZ, rezulton se ato konsistojnë sigurisht vetëm tek ekzistenca e një vendimi penal të vitit 2009.

Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka verifikuar dhe nuk pretendon si fakte që përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2 të Ligjit, dy elementët e tjerë, pra:

- Në vitin 1995, është raportuar nga policia në Foggia, për krime në lidhje me falsifikimin e parave;
- Subjekti është kontrolluar disa herë nga policia.

Për këto dy pretendime Prokuroria e Përgjithshme, duke qenë se nuk bëhet fjalë për asnjë ndalim, arrestim, masë sigurimi personal shtrënguese, dëbim dhe për më tepër në asnjë rast për ekzistencën e ndonjë vendimi gjyqësor përfundimtar ose jo, nuk ka asnjë pretendim, duke i përjashtuar ato rrjedhimisht nga fusha e zbatimit të ligjit.

Rrjedhimisht, duke qenë se këto dy raste, nuk përfshihen në asnjë nga rastet e përcaktuara nga neni 2 “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”, atëherë nuk mund të shqyrtohej dhe as të verifikohej nga KQZ nëse ato përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit “Periudha e ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar”, për sa i përket përfshirjes apo jo brenda periudhës së ndalimit.

Ndërsa për rastin e tretë, atë të dënimit në vitin 2009 nga Gjykata e Ravenës, z. Dashamir Tahiri, pasi është njohur me këtë pretendim të Prokurorisë së Përgjithshme, me shqetësim ka kërkuar dhe ka marrë në shtetin italian Vendimin e Gjykatës së Ravenës, i datës 29.05.2009, për ekzistencën e të cilit, ashtu siç dhe ka theksuar edhe përpara Prokurorisë së Përgjithshme deklaroi se nuk ka pasur asnjë dënim. Këtë vendim ne ia vendosëm në dispozicion KQZ-së, për qartësimin e pretendimeve tona.

Nga përmbajtja e Vendimit, rezulton se ai është shpallur në datën 29.05.2009 nga Gjykata e Ravenas, Republika e Italisë, e përbërë nga Gjyqtari i vetëm i shkallës së parë

dhe në atë gjykim, z. Dashamir Tahiri është gjykuar në mungesë. Fakti i cili i është atribuuar është ngjarja e plot 5 (pesë) viteve më parë, konkretisht në datën 17.02.2004 (!) për pretendimin e përdorimit prej tij të një Lejeje Drejtimit të falsifikuar.

Po ashtu, në vendim arsyetohet se ngjarja është konstatuar nga personeli i Policisë Bashkiake të qytetit të Ravenas, Itali, i cili ka shqyrtuar faktin se z. Dashamir Tahiri ka treguar një Leje Drejtimi Ndërkombëtare Shqiptare, e cila kishte pasaktësi në lidhje me: *"kapjen me kapse, fletët e pamarkuara, prania e gabimeve ortografike në përkthimin në italisht dhe defektet në fletët e brendshme"*. Sipas vendimit gjyqësor, subjekti (z. Tahiri) edhe pse nuk ka kontribuar në falsifikimin e dokumentit, rezervon paraqitjen në dukje të ligjshme, në respekt të normave të qarkullimit rrugor, pasi i akuzuari ka vendosur (ose ja kanë vendosur) fotografinë e tij, mbi këtë dokument.

Sipas gjykatës italiane, ka rezultuar jo vetëm vlera ekonomike e vogël e dokumentit të pretenduar si i falsifikuar (brenda limit të të parëndësishmes siç arsyetohet), por dhe për përmbajtjen pa vlerë juridike të faktit të akuzuar, në rrethanat e kontrollit, duke qenë se i akuzuari kishte në posedim të tij edhe një Patentë drejtimi të rregullt dhe të vërtetë.

Vendimi gjyqësor ka përcaktuar një dënim prej 9 muaj burgim dhe 300 Euro gjobë, por njëkohësisht, ka deklaruar këtë dënim si tërësisht të falur, sipas nenit 174 të Kodit Penal italian dhe Ligjit nr. 241/2006 "Për Faljen".

Rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë, është bërë "i parevokueshëm" sipas ligjit italian, në datën 28.10.2009, duke u cilësuar në përmbajtjen e tij fakti se, z. Tahiri është gjykuar në mungesë dhe komunikimi i vendimit është bërë sipas nenit 161, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë, dispozitë e cila aplikohet në rastet e pamundësisë së njoftimit të të akuzuarit, pasi ai nuk ka qenë prezent gjatë gjyqimit (gjykuar në mungesë) dhe njoftimi i bëhet mbrojtësit të tij.

Në referim të dispozitave të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", konkretisht nenit 2 të tij parashikohet se:

Neni 2

Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik

1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të

marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

- a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;
- b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;
- c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;
- d) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Në rastin konkret, rezulton se vepra për të cilën është dhënë në mungesë të z. Dashamir Tahiri, vendimi i Gjykatës së Ravenas, nuk përfshihet në veprat penale të specifikuara sipas germës a), të pikës 1, të nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015.

Veprat e "falsifikimit të dokumenteve", sipas Kreut III "Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike", Seksioni VIII "Falsifikimi i Dokumenteve" të Kodit Penal shqiptar, nuk janë përfshirë nga ligjvënësi ndër veprat ndaluese për ushtrimin e funksionit, sipas germës a), të pikës 1, të nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015.

Ky fakt është pranuar edhe nga Prokuroria e Përgjithshme në vendimin e saj të datës 20.12.2016, duke u pretenduar nga ky institucion se, duke qenë se nuk plotësohen kushtet e germave a) dhe b), atëherë ky rast përfshihet në fushën e zbatimit të germës ç) të pikës 1 të nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015, dispozitë e cila aplikohet: për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Diferenca midis këtyre dispozitave, është sigurisht fakti se, rasti i germës ç) të pikës 1 të nenit 2 gjën aplikim vetëm nëse krimi, i cili nuk përshihet në shkronjat a) dhe b) të kësaj

pike, është kryer me dashje dhe njëkohësisht dënimi i dhënë është jo më pak se 6 muaj burgim.

Nëse në rastet e germave a) dhe b) kryerja e veprave penale vlerësohet edhe nëse është realizuar me veprim apo mosveprim, në rastin e germës ç) kërkohet detyrimisht ekzistenca e "dashjes".

Dënimi i dhënë sipas gjykatës italiane është bazuar në nenet 489 "Përdorimi i akteve të rreme" dhe 648 "Pranimi", të cilat dispozita përfshijnë: marrjen pjesë në falsifikim, madje për këtë fakt ulet 1/3 e dënimit, si edhe bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale. Elementë të cilët kërkojmë të interpretohen nga gjykata në drejtim të mungesës së elementit "dashje", në rastin e z. Dashamir Tahiri.

Përveç sa më lart, thelbësore për shqyrtimin që KQZ ndërmorri në rastin e z. Dashamir Tahiri, është përcaktimi i nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015 "Periudha e ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar", pika 4 e të cilit parashikon shprehimisht se:

"Për personat e dënuar për kryerjen e një krimi që parashikohet nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal".

Në rastin objekt shqyrtimi, theksohet se jo vetëm që nuk ka ekzistuar dënimi me burgim, pasi dënimi është deklaruar tërësisht i falur nga Gjykata e Ravenës (ka ekzistuar shkak padënueshmërie për shkak të Ligjit italian nr. 241/2006 "Për Faljen" dhe pavarësisht aplikimit të pikës 9 të nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015), por tanimë kanë kaluar të gjitha afatet kohore, të cilat sot passjellin pamundësinë e aplikimit të pikës 4 të nenit 4 të Ligjit.

Sipas nenit 69 të Kodit Penal shqiptar "Rehabilitimi", parashikohet se:

"Quhen të padënuar:

... b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga 6 (gjashtë) muaj gjer në 5 (pesë) vjet dhe që gjatë 5 (pesë) vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer veprë tjetër penale".

Siç theksuam dhe analizuam më lart, Vendimi i Gjykatës së Ravenas i datës 29.05.2009, ka marrë formë të prerë, duke u bërë i përvokueshëm, në datën 28.10.2009, duke u

deklaruar madje tërësisht i falur dënimi që në datën 29.05.2009, çka bën që, në interpretim të ligjit, nga ky moment, të nisë periudha e rehabilitimit, e cila ka përfunduar në fund të afatit 5 – vjeçar, në datën 29.05.2014.

Duke qenë se, ndalimi ligjor, sipas pikës 4 të nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015 zgjat deri në momentin e rehabilitimit (sipas nenit 69 të Kodit Penal) të personit të dënuar për krime të parashikuar nga germa ç) e pikës 1 të nenit 2 të Ligjit, në rastin e z. Dashamir Tahiri, rezulton qartë se kjo periudhë ndalimi ka përfunduar prej më shumë se 2,5 vitesh tanimë (në datën 29.05.2014), moment kur ende nuk ekzistonte Ligji 138/2015!!

Siç referuam më lart edhe nëse aplikohen dispozitat e pikës 9, të nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015, paditësi rezulton të jetë rehabilituar tërësisht! Kjo dispozitë përcakton se:

“Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, edhe nëse përllogariten afatet duke përfshirë atë 5-vjeçar të rehabilitimit dhe atë 9 mujor të dënimit të dhënë (pavarësisht faljes së plotë dhe pamundësisë së ekzekutimit të tij, për shkak të kësaj faljeje), sërisht rezulton e qartë se paditësi Dashamir Tahiri nuk ndodhet në kushtet e ndalimit, sipas Ligjit nr. 138/2015, fakt të cilin duhet ta kishte konstatuar KQZ në vendimmarrjen e tij. Në kundërshtim me provat dhe aktet që shqyrtoi, KQZ (e theksojmë me shumicë të thjeshtë votash prej 4 anëtarësh) ka prodhuar një vendimarrje tërësisht në kundërshtim me ligjin, rast ky i cili do të përbëjë edhe precedent, duke interpretuar në mënyrën më të gabuar të mundshme këtë ligj dhe duke cenuar kësisoj të drejtat e ligjshme të paditësit Dashamir Tahiri.

Ne ritheksojmë faktin se, z. Dashamir Tahiri, nuk ndodhet sot dhe nuk është ndodhur as në momentin e miratimit të ligjit, as në momentin e plotësimit dhe depozitimit të Formularit të Vetëdeklarimit pranë KQZ, as në momentin e marrjes së Vendimit nga Prokuroria e Përgjithshme dhe as në momentin e marrjes së Vendimit nr. 176, datë 29.12.2016 nga KQZ, në kushtet e nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015: “Ndalimi për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik”.


KËRKIMI PËRFUNDIMTAR:

Në përfundim, bazuar në sa më lart parashtruar dhe argumentuar, duke qenë se në rastin dhe personin e z. Dashamir Tahiri provohet se nuk plotësohen kërkesat e ligjit, pasi të dhënat e pretenduara nga Prokuroria e Përgjithshme nuk përfshihen brenda periudhës së ndalimit, sipas përcaktimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kërkojmë nga Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë:


1. Gjykimin e çështjes në themel.
2. Shfuqizimin e Vendimit nr. 176, datë 29.12.2016 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Dashamir Tahiri, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike', me të cilin është shpallur i pavlefshëm dhe përfunduar në mënyrë të parakohshme mandati i deputetit z. Dashamir Tahiri.

Tiranë, më 31.12.2016

PADITËSI


Dashamir TAHIRI


Av. Fatmir BRAKA


Av. Julian MËRTIRI

